



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE E GJILANIT
OSNOVNI SUD GNJILANE – BASIC COURT OF GJILAN



Raporti i rregullt i punës
GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Tetor - Dhjetor 2024

Bazuar në nenin 14, pika 2 nën pika 2.5 të Ligjit për Gjykatat dhe pika 5 e nenit 11 të Rregullores Nr. 02/2020 për Organizimin dhe Veprimtarinë e Brendshme të Gjykatave të Republikës së Kosovës, Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan paraqet raportin e rregullt të punës.

Raporti i rregullt i punës së Gjykatës Themelore në Gjilan përfshinë periudhën raportuese nga 1 tetor deri më 31 Dhjetor 2024.

I. Hyrje

Raporti i Gjykatës Themelore të Gjilanit paraqet të gjitha të dhënat statistikore për këtë periudhë, të arriturat, sfidat, por edhe pengesat që kanë qenë gjatë kësaj periudhe.

II. Struktura e Gjykatës Themelore në Gjilan me Degët e saja

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit aktualisht kemi 19 gjyqtarë aktiv duke llogaritur edhe Kryetarin, kurse një gjyqtare kemi në trajnim fillestar. Në Degën e Kamenicës kemi 3 gjyqtar aktiv. Në Degën e Vitisë kemi 6 gjyqtarë, ndërsa në Novobërdë kemi 1 gjyqtar dhe Mbikëqyrësin e Degës i cili është i angazhuar edhe në qendër.

Në Departamentin e Krimeve të Rënda kemi 5 gjyqtarë, dhe të gjithë gjyqtarët e këtij departamenti janë të ngarkuar me lëndë të Departamentit të Përgjithshëm – Divizioni Penal dhe në të njëjtën kohë janë të angazhuar edhe në Degët e kësaj gjykate.

Në Departamentin për të Mitur punon 1 gjyqtar dhe të njëjtën kohë është i ngarkuar me lëndë penale të Departamentit të Përgjithshëm, ndërsa në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal janë të caktuar 2 gjyqtarë, ku njëri gjyqtar (Mevlide Shabani) është e ngarkuar edhe me lëndë civile – kontestimore, ku gjatë këtij viti kryesisht i ka dhënë prioritet lëndëve civile, kurse në penale ka caktuar dhe gjykuar lëndët me prioritet ligjor.

Në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Civil momentalisht i ndahen lëndët 7 gjyqtarëve, kurse janë të angazhuar edhe 3 gjyqtarë tjerë (2 nga Degët dhe 1 nga DP – Divizioni Penal) për të gjykuar lëndë civile.

Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Kundërvajtjes punojnë 2 gjyqtarë.

Dega e Gjykatës Themelore në Kamenicë: Kjo degë aktualisht ka 3 gjyqtarë të rregullt, ku dy gjyqtarë janë të ngarkuar me lëndë civile kontestimore, një gjyqtar është i ngarkuar me lëndë penale dhe kundërvajtje, i cili në të njëjtën kohë gjykon edhe lëndët penal dhe kundërvajtjes në Degën e Novobërdës. Mbikëqyrësja – gjyqtarja përveç lëndëve kontestimore është e ngarkuar edhe me procedurën paraprake.

Dega e Gjykatës Themelore në Viti: Në këtë degë kemi aktualisht kemi 6 gjyqtarë, prej tyre 1 gjyqtarë në Departamentin e Përgjithshëm – Divizioni Penal ndërsa 5 gjyqtarë në Divizionin Civil, ku njëri gjyqtar është i ngarkuar edhe me procedurën penale – paraprake dhe gjithashtu të njëjtit nga mes i shtatorit është dhënë një numër i caktuar i lëndëve civile kontestimore në qendër. Gjithashtu në këtë degë nga qendra kemi angazhuar 5 gjyqtarë nga DKR-ja, 2 gjyqtarë nga Departamenti i Përgjithshëm dhe 1 gjyqtar nga Divizioni Kundërvajtjes.


Dega e Gjykatës Themelore në Novobërdë: Në këtë degë kemi 1 gjyqtar i cili gjykon lëndët të Divizionit Civil. Mbikëqyrësi është i ngarkuar me një numër të caktuar të lëndëve civile në këtë degë dhe në Gjilan, ndërsa lëndë penale dhe të kundërvajtjes i gjykon gjyqtari i Degës së Gjykatës Themelore në Kamenicë, Sadri Krasniqi.

Në Gjykatën Themelore të Gjilanit, lëndët ndahen me Sistemin e Programit SMIL, ashtu siç është caktuar me Rregulloren mbi veprimtarinë e gjykatave.


III. Raportet statistikore

Të dhënat statistikore i kemi të paraqitur në formë tabelare të cilat janë të nxjerra nga Programi SMIL.


Efikasiteti në përqindje (%) i Gjykatës së bashku me Degët



Efikasiteti në përqindje (%) i Gjykatës dhe Degëve




GJYKATA THEMELORE GJILAN




Gjykata Themelore Gjilan	Lëmia	Lëndët e trashëguara	Lëndët e ardhura	Gjithsejtë lëndët në punë	Lëndët e krvera	Lëndët e mbetura	Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura II - IV
		I	II	III	IV	V	
Dep. Krimeve të Rënda	Paraprake	290	<u>42</u>	332	<u>39</u>	293	<u>93 %</u>
	Penale	450	<u>37</u>	487	<u>51</u>	436	<u>138 %</u>
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	518	<u>40</u>	558	<u>31</u>	527	<u>78 %</u>
	Penale	1367	<u>272</u>	1639	<u>274</u>	1365	<u>101 %</u>
	Civile	5869	<u>1169</u>	7038	<u>2319</u>	4718	<u>198 %</u>
	Jokontestimore	168	<u>56</u>	224	<u>62</u>	162	<u>111 %</u>
	Përmbarrimore	282	<u>17</u>	299	<u>28</u>	271	<u>165 %</u>
Dep. për të Mitur	Përgatitore për të mitur	32	<u>3</u>	35	<u>2</u>	33	<u>67 %</u>
	Penale para kolegjit	112	<u>36</u>	148	<u>19</u>	129	<u>53 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	1494	<u>444</u>	1938	<u>463</u>	1475	<u>104 %</u>
	TOTALI	10582	<u>2116</u>	12698	<u>3288</u>	9409	<u>155 %</u>

DEGA E GJYKATËS THEMELORE KAMENICË




Dega e Kamenicë	Themelores Lëmia	Lëndët e trashëguara I	<u>Lëndët e ardhura</u> II	Gjithsejtë lëndët në punë III	<u>Lëndët e krvera</u> IV	Lëndët e mbetura V	<u>Përqindia e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> II - IV %
	Paraprake	92	<u>28</u>	120	<u>19</u>	101	<u>68 %</u>
	Penale	130	<u>58</u>	188	<u>38</u>	150	<u>66 %</u>
	Civile	1143	<u>138</u>	1281	<u>456</u>	825	<u>330 %</u>
	Jokontestimore	33	<u>5</u>	38	<u>12</u>	26	<u>240 %</u>
	Pëmbarimore	70	<u>7</u>	77	<u>27</u>	50	<u>386 %</u>
	Kundërvajtje	408	<u>125</u>	533	<u>79</u>	454	<u>63 %</u>
TOTALI		1876	<u>361</u>	2237	<u>631</u>	1606	<u>174 %</u>

DEGA E GJYKATËS THEMELORE VITI



Dega e Themelores Viti	Lëndët e trashëguara	<u>Lëndët e ardhura</u>	Gjithsejtë lëndët në punë	<u>Lëndët e kryera</u>	Lëndët e mbetura	<u>Përgjindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u>	
Lëmia	I	<u>II</u>	III	<u>IV</u>	V	<u>II - IV %</u>	
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	63	<u>64</u>	127	<u>39</u>	88	<u>61 %</u>
	Penale	868	<u>165</u>	1033	<u>196</u>	837	<u>119 %</u>
	Civile	1905	<u>455</u>	2360	<u>411</u>	1949	<u>90 %</u>
	Jokontestimore	32	<u>8</u>	40	<u>11</u>	29	<u>138 %</u>
	Përmbarimore	471	<u>14</u>	485	<u>12</u>	473	<u>86 %</u>
	Kundërvajtje	695	<u>154</u>	849	<u>168</u>	681	<u>109 %</u>
TOTALI	4034	<u>860</u>	4894	<u>837</u>	4057	<u>97 %</u>	

DEGA E GJYKATËS THEMELORE NOVOBËRDË



Dega e Themelores Novobërdë	Lëmia	Lëndët e trashëguara I	<u>Lëndët e ardhura</u> II	Gjithsejtë lëndët në punë III	<u>Lëndët e krvera</u> IV	Lëndët e mbetura V	<u>Përqindja e lëndëve të ardhur dhe të zgjidhura</u> II - IV %
Dep. Përgjithshëm	Paraprake	14	<u>1</u>	15	<u>1</u>	14	<u>100 %</u>
	Penale	140	<u>30</u>	170	<u>24</u>	146	<u>80 %</u>
	Civile	343	<u>36</u>	379	<u>43</u>	336	<u>119 %</u>
	Jokontestimore	56	<u>3</u>	59	<u>22</u>	37	<u>733 %</u>
	Përmbartimore	40	<u>19</u>	59	<u>13</u>	46	<u>68 %</u>
Divizioni Kundërvajtjes	Kundërvajtje	174	<u>59</u>	233	<u>38</u>	195	<u>64 %</u>
TOTALI		767	<u>148</u>	915	<u>141</u>	774	<u>95 %</u>

Statistikat e përgjithshme

Gjykata Themelore në Gjiilan së bashku me Degët në tremujorin e tretë (tetor – nëntor - dhjetor) efikasitetin e zgjidhjes së lëndëve e ka 136 %.

IV. Përmbushja e objektivave

a) **Zvogëlimi i ngarkesës së lëndëve për gjyqtarë dhe ndarja e tyre:** sipas Planit të Punës për këtë vit një ndër objektivat kemi paraparë barazimin e të gjithë gjyqtarëve me lëndë, këtë objektiv e kemi arritur në tremujorin e parë dhe tani të gjithë gjyqtarët (duke përfshirë edhe degët) që punojnë në lëminë civile, penale, kundërvajtje janë të ngarkuar njësoj me lëndë (+ - 15-20 lëndë) dhe konsideroj se kemi pasur një angazhim të mirë dhe rezultati nuk ka munguar. Sa i përket angazhimit gjyqtarët në qendër pothuajse të gjithë janë kënaqshëm të angazhuar, kurse nëpër degë ka hapësirë edhe shumë më tepër sesa që janë duke punuar – angazhuar, ku edhe në këtë tremujor kemi vizituar degët, kemi takuar gjyqtarët dhe nga ta kemi kërkuar që të angazhohen shumë më tepër kemi kërkuar që të caktohen sipas radhës, lëndët e vjetra, lëndët e rigjykimit, lëndët me prioritet ligjor.

Në këtë tremujor kemi arritur objektivin, në qendër në Divizionin Civil janë përfunduar pothuajse të gjithë lëndët që kanë arritur në gjykatë deri në vitin 2022, me përjashtim të ndonjë rasti që ka probleme procedurale për tu procesuar. 1

b) **Sa i përket Departamentit për Krime të Rënda:** gjyqtarët e këtij departamentit edhe në këtë tremujor kanë gjykuar lëndë të Departamentit të Përgjithshëm në qendër si dhe Degën e Vitisë, me të vetmin qëllim ngritjen e efikasitetit dhe trajtimin e barabartë të gjithë gjyqtarëve.

c) **Rritja e transparencës së gjykatës:** edhe në këtë tremujor kemi kontribuar në rritje të transparencës, duke pritur në takim qytetarët, avokatët përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të institucioneve lokale dhe shoqërisë civile. Kemi pranuar disa kërkesa për qasje në dokumente zyrtare, pyetje

të gazetarëve dhe ju kemi përgjigjur brenda afatit kërkesave. Gjithashtu kemi bërë përpjekje për të publikuar sa më tepër vendime gjyqësore, ku këtë tremujor kemi publikuar 1369 vendime gjyqësore.

V. Identifikimi i problemeve me të cilat është ballafaquar gjykata

Disa nga sfidat të cilat janë paraqitur gjatë muajve tetor - dhjetor të vitit 2024, janë të ngjashme me tremujorshit paraprak, por kemi edhe sfida të tjera edhe atë do ti listojmë si më poshtë:

- a) Si sfidë e kësaj gjykate në këtë tre mujor ka qenë në Divizionin Civil, për shkak të ngarkesës në këtë divizion, pasi që gjatë këtij tre mujori kemi pasur ardhje të shumta të lëndëve por edhe kemi kryer numër të kënaqshëm të lëndëve, por gjyqtarët të lëmisë civile të cilët punojnë në qendër janë shumë të ngarkuar me seanca të shumta dhe janë duke kryer lëndë të vjetra, lëndë të rigjykimit, lëndë me prioritet ligjor, kurse ekipa e bashkëpunëtorëve profesional përfundojnë lëndët nga kontratat kolektive dhe konsiderojmë se të gjithë bashkëveprojnë në mes veti dhe kemi këtë rezultat pozitiv. Ne si Gjykatë gjatë këtij tremujori në krahasim me muajt të mëparshëm kemi punuar me më pak gjyqtarë, por prapë se prapë gjyqtarët, bashkëpunëtorët dhe stafi tjetër, në veçanti të qendrës janë duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në ngritjen e efikasitetit.
- b) Stafi administrativ përkatësisht zyrtaret ligjore – sekretaret juridike ku disa prej tyre janë në moshë të shtyrë dhe kanë probleme me shëndetin, me përdorimin e teknologjisë e gjithashtu kemi mungesë të zyrtareve ligjore, përkatësisht kemi 3 gjyqtarë pa zyrtare ligjore, por mbulohen me praktikantë dhe pjesërisht me zyrtaret të cilat i marrim nga gjyqtarët e tjerë.
- c) Sa i përket stafit administrativ që janë punësuar kemi pasur probleme të ndryshme në organizimin e punës edhe këtë tre mujor mirëpo tanimë të gjithë respektojnë orarin, vendin dhe detyrat e punës dhe angazhohen maksimalisht rreth detyrave të tyre të punës.
- d) Për Gjykatën Themelore në Gjilan së bashku me degët si problem është edhe numri jo i kënaqshëm i gjyqtarëve (jemi minimum të mbuluar me gjyqtarë), por fatmirësisht jemi duke funksionuar dhe punuar shumë tepër sesa në të kaluarën.

e) Një sfidë tjetër për lëndët penale është mungesa e prokurorëve si në qendër ashtu edhe në Degët Kamenicë, Viti dhe Novobërdë, ku ka mungesë të theksuar të prokurorëve dhe për këtë çështje Kryetari i Gjykatës disa herë ka biseduar dhe është takuar me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ku i njëjti na ka njoftuar se pa u bërë plotësimi i vendeve të lira në këtë prokurori nuk mund të përmirësohet gjendja por tanimë në këtë prokurori janë emëruar 4 prokurorë ku të njëjtit tani janë aktiv dhe gjendja presim që edhe më tepër përmirësohet.

f) Sa i përket Sistemit SMIL, ne më lartë i kemi paraqitur statistikën, por të njëjtat nuk janë të sakta sa i përket ngarkesës së gjyqtarëve dhe gjykatës në përgjithësi dhe në vazhdimësi me personat përgjegjës të SKGJK-së kemi bërë përpjekje të eliminojmë këto gabime në raporte statistikore dhe gabime të tjera, por deri në këtë moment nuk kemi arritur dhe padyshim që paraqitet si problematik në punën ditore të gjykatës. Gjithashtu na paraqiten probleme të ndryshme në Sistemin SMIL dhe në mungesë të trajnerëve të SMIL-it po kemi vështirësi në zgjidhjen e problemeve;

i) Sa i përket teknologjisë kemi mungesë të printerëve funksional, nëpër zyre të stafit (gjyqësore dhe administrativ), gjithashtu ka probleme të vazhdueshme edhe nëpër salla të gjyqimeve përkundër se tanimë pranë gjykatës tonë është bërë instalimi i pajisjeve audio vizuale në njërin prej sallave të gjyqimit e po ashtu edhe në disa të tjera janë ndërruar pajisjet kompjuterike.

VI. Propozimi i hapave riparues

Kërkojmë nga KGJK dhe SKGJK-ja që të rekrutoj gjyqtarë dhe bashkëpunorë profesional për këtë Gjykatë dhe degët e saj, të rekrutojnë zyrtare ligjore dhe procesi i rekrutimit të përfundojë sa më shpejt që është e mundur. Gjithashtu të mbuloj pozitën e paplotësuar për bashkëpunorë profesional duke përfshirë edhe Degët, si dhe për përkthyes gjyqësor për Degën e Kamenicës (pasi që kjo degë me përkthyes mbulohet nga përkthyesit që janë të punësuar në qendër). Gjithashtu është e nevojshme që të organizohen trajnime për stafin administrativ dhe për bashkëpunorë profesional, në veçanti trajnime për shkrim dhe arsyetim ligjor, si dhe për institute të ndryshme.

VII. Të arriturat

Në tremujorin e tretë të vitit 2024 në secilin departament, divizion dhe degë ka pasur arritje – ngritje të efikasitetit dhe përpjekje maksimale që të përfundohen sa më shumë lëndë. Gjithashtu nuk kemi probleme sa i përket respektimit të orarit, vendit dhe detyrat e punës nga të gjithë të punësuarit në këtë Gjykatë dhe çdo ditë e më tepër rritet efikasiteti, llogaridhënia dhe përgjegjësia e gjithë punonjësve të kësaj gjykate.

VIII. Përfundimi

Në bazë të dhënave statistikore jemi të kënaqur, por siç thash më lartë në vazhdimësi bëjmë përpjekje, kërkojmë, bisedojmë që gjyqtarët dhe stafit tjetër administrativ të jetë më efektiv, kurse sa i përket gjyqtarëve nga të njëjtit në vazhdimësi kemi kërkuar që të caktojnë – procedojnë lëndë sa më tepër që është e mundur, të caktojnë lëndët e rigjyimit, lëndët me prioritet ligjor dhe të trajtojnë lëndët, duke bazuar në parimin e arritjes në gjykatë dhe konsideroj që në muajt në vijim do të ketë edhe më tepër rezultate për përfundimin e lëndëve.

Sa i përket, transparencës, llogaridhënies, objektivitetit, paanshmërisë dhe pavarësisë, në vazhdimësi kërkojmë nga gjyqtarët dhe të njëjtit i inkurajojmë që të jenë të pavarur dhe të paanshëm në trajtimin e çështjeve, pasi që kthimi i besimit në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe në sistemin e drejtësisë në përgjithësi është njëri ndër objektivat kryesore dhe kjo mund të arrihet me punë, angazhim serioz dhe të vazhdueshëm nga gjithë punonjësit e kësaj gjykate.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, Venhar Salihu



Me datë 14.01.2025